



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
KUVEJDI KOMUNAL RAHOVEC / SKUPSTINA OPŠTINE ORAHOVAC / MUNICIPAL ASSEMBLY RAHOVEC
KOMUNA E RAHOVECI
Drejtoria për Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje



Nr. I prot. 36
Br. prot. 13.02.2018
RAHOVEC - ORAHOVAC
Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje
Department of Education

Në bazë të nenit 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-40, neni 6 të Statutit të Komunës, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.08/2014 të datës 25.02.2014, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

KONKURS

I-Për drejtor dhe zëvendësdrejtor të SHFMU të komunës së Rahovecit

- 1) Një drejtor për SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec
- 2) Një zëvendësdrejtor për SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec

Kushtet për konkurim:

1. Të gjithë kandidatët e interesuar për konkurim në vendet e punës për drejtor shkolle duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
 - 1.2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe Normativit mbi punësimin e kuadrit të mësimdhënësve dhe rregullativës tjetër ligjore.
 - 1.3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit.
2. Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim e menaxhim.
3. Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione arsimore.
4. Kandidatët konkurent duhet të posedojnë këto dokumente:
 - 4.1. Ekstraktin e lindjes
 - 4.2. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës
 - 4.3. Dëshminë për përvojën e punës
 - 4.4. Portfolijen profesionale (shihni shtojcën G” të U A 08/2014)
 - 4.5. Letër referencë nga një institucion publik kredibil (si MASHT-i, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë)
 - 4.6. Letër referencë duhet të kenë përmbajtje dëshmuere për punën dhe angazhimet paraprake.
 - 4.7. Planin zhvillimor të institucionit edukativo arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
 - 4.8. Certifikatën shëndetsore të lëshuar nga një institucion publik shëndetsor.
 - 4.9. Dëshminë se nuk është nën hetim.

Detyrat e punës:

Detyrat e punës së drejtorit të shkollës janë të përcaktuara në rregulloret për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollë.

Kohëzgjatja :Marrëdhënia e punës lidhet përmes kontratës ,në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe zgjat 4(katër) vite, duke e përfshirë edhe periudhën tremujore provuese.

Aplikacionet për konkurim merren në DKA dhe dokumentet dorëzohen po aty.

Afati i konkurimit është 15 ditë nga dita e shpalljes të konkursit.

RAHOVEC

13.02.2018

